



Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-70/05-21085/18 datë: 17.07.2018, të znj.Demrije Salihaj, Kryetare e OVL-ë të UÇK-së Shtime, e cila ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, Anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes numër 01Nr.06/2063-251 të datës 29.10.2010, për dhënien në menaxhim të përkohshëm - Tregjet dhe Parkingjet, Organizatës së Veteranëve të Luftës. Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES ME NUMËR 01Nr.06/2063-251 TË DATËS 29.10.2010

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 25.09.2018, unanimisht vendosi të Anuloj vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, numër 01Nr.06/2063-251 të datës 29.10.2010, për dhënien në menaxhim të përkohshëm - Tregjet dhe Parkingjet, Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në Shtime.

II

A r s y e t i m: Kuvendi ka aprovuar kërkesën Nr.01-70/05-21085/18 datë: 17.07.2018, të znj.Demrije Salihaj, Kryetare e OVL-ë të UÇK-së në komunën e Shtimes, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke marrë për bazë arsyetimin e parashtrueses së kërkesës, si dhe Rekomandimet që kanë dhënë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-27804/18 datë: 13.09.2018



Npi – 01/251 Datë: 25.09.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-21221/18 datë: 18.07.2018, të z.Ibrahim Bunjaku, kryetar i SH.I.L. dhe z.Muhamet Bilalli, kryetar i SH.F.D. – Shtime, të cilët kanë kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, Anulimin e Vendimit 01Nr.06/2063-251 të datës 29.10.2010, për dhënien në menaxhim të përkohshëm - Tregjet dhe Parkingjet, Organizatës së Veteranëve të Luftës, së UÇK-së, dhe njëkohësisht kërkojmë që të aprovohet vendimi për dhënien e parkingjeve në menaxhim, SH.F.D-së dhe SH.I.L të UÇK-së. Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, Aprovoi:

V E N D I M

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS Nr.01-070/05-21221/18 TË
IBRAHIM BUNJAKU, KRYETAR I SH.I.L. DHE MUHAMET BILALLI, KRYETAR I
SH.F.D. – SHTIME**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 25.09.2018, me shumicën e votave vendosi të Refuzoi, kërkesën Nr.01-070/05-21221/18 datë: 18.07.2018, e të z.Ibrahim Bunjaku, kryetar i Shoqatës të Invalidëve të Luftës së UÇK-së, si dhe z.Muhamet Bilalli, kryetar i Shoqatës të Familjarëve të Dëshmorëve, në komunën e Shtimes, të cilët kanë kërkuar për tua dhënë për menaxhim të përkohshëm Tregun dhe Parkingjet në rrugën "Tahir Sinani" në Shtime, Organizatave SH.F.D dhe SH.I.L të UÇK-së, në Shtime.

II

A r s y e t i m: Kuvendi ka refuzuar kërkesën Nr.01-070/05-21221/18 datë: 18.07.2018, të z.Ibrahim Bunjaku, kryetar i SH.I.L. dhe z.Muhamet Bilalli, kryetar i SH.F.D. – Shtime, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi, duke marrë për bazë edhe Rekomandimet që kanë dhënë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-27804/18 datë: 13.09.2018



Npi – 01/252 Datë: 25.09.2018

Duke u Bazuar në nenin 12 dhe 17 pika (n) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2018 e mbajtur më: 25.09.2018, Aprovoi:

V E N D I M

PËR DHËNJEN NË MENAXHIM TË PËRKOHSHËM - TREGJET DHE PARKINGJET NË SHTIME KOMANISË RAJONALE “PASTËRTIA” NJËSIA NË SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt të mbajtur më datën: 25.09.2018 me shumicën e votave Aprovoi, Vendimin për dhënjën në menaxhim të përkohshëm, Kompanisë Rajonale “Pastërtia” Njësia në Shtime, Parkingjet në rrugën kryesore dhe Tregjet në Shtime.

II

Kuvendi i Komunës rezervon të drejtën që këtë vendim ta anulojë mbi bazën e nevojave dhe interesave të Komunës së Shtimes, sikurse edhe në rastet e mosrespektimit të këtij vendimi.

III

Implementimin e vendimit sa i përket konkretizimit të punëve dhe obligimeve që kanë të bëjnë me caktimin e Vend-parkingjeve, shejëzimin e nevojshëm, caktimi i tarifës për pagesë, kohëzgjatja e kontratës, etj. kryhet me kontratë të veçant nga Administrata Komunale sipas Rregulloreve në fuqi.

IV

Kompania Rajonale “Pastërtia” Njësia në Shtime, sipas këtij vendimi është e obliguar që para Kuvendit të Komunës së Shtimes të Raportoje për punën dhe aktivitetet financiare, së paku një herë në gjashtë muaj.

V

Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/2063-251 të datës 29.10.2010. Anullohet.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

VII

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj.